KOLË XHUMARI

Abetare



SHTËPIA BOTUESE E LIBRIT SHKOLLOR

Miratuar nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës

Shënim

Në rubrikën "Ushtrime", kërkesat që janë shkruar me shkronja të vogla pranë numërorëve 1,2 etj., janë për mësuesin dhe prindin, në bazë të të cilave ata do t'i udhëzojnë fëmijët për punën e pavarur që do të kryejnë.

Recensentë:
Dr. Mimoza Gjokutaj, Mr. Abdyl Ramaj, Agim Sinani

Redaktor përgjegjës:
Loredan Bubani

Ilustrimet:
Llazar Taçi, Buron Kaceli, Jrma Toptani, Jkbal Beli

Kopertina:
Remzi Kuçi

Realizimi në kompjuter:
Skënder Begu, Agron Pullumbi

Botim i parë: 1994
Ribotim: 1995
Ripunim: 1996
Ribotim: 1997, 1998, 1999
Ripunim: 2000
Ribotim: 2001

ISBN 99927-2-446-3

MAMI

mami

SOKOLI

Sokoli

LIRIA

Liria

MAMI, LIRIA DHE SOKOLI

mami, Liria dhe Sokoli

mami,	Liria	dhe	Sokoli

mami dhe Liria

mami dhe Sokoli

mami, Liria dhe Sokoli



LIRIA DHE SOKOLI KANË LULE.

Liria dhe Sokoli kanë lule.

Liria	dhe	Sokoli	kanë	lule.

Sokoli dhe Liria kanë lule.

Lule kanë Sokoli dhe Liria.

Kanë lule Liria dhe Sokoli.

SOKOLI KA NJË LULE.

Sokoli ka një lule.

Sokoli	ka	një	lule.

So	ko	li

li

i

Sokoli ka një lule.

Liria ka një lule.

Mami, Sokoli dhe Liria kanë lule.

USHTRIME

1. Qarko me laps të kuq shkronjën **i** në një faqe gazete ose libri.

2. Lexo fjalitë, duke plotësuar fjalët.

Mami ka një l..l..

Sokoli ka një lule.

3. Lexo fjalitë, duke plotësuar rrokjet e fjalëve.

Liria ka një lu..

So..li ka një l..le.

4. Lexo rrokjet e para të emrave poshtë figurave.

sorrë kovë limon

MAMI KA LULE TË KUQE.

Mami ka lule të kuqe.

Mami	ka	lule	të	kuqe.

lu	le

lu

u

u U



Mami ka lule të kuqe.

Liria ka lule të kuqe.

Dhe Sokoli ka lule të kuqe.

USHTRIME

1. Qarko me laps të kuq shkronjën **u** në fletën e kontrollit.

2. Lexo fjalitë, duke plotësuar fjalët.

Mami ka lule të kuqe.

Sokoli ka lule të kuqe.

Dhe sokoli ka lule të kuqe.

3. Lexo fjalitë, duke plotësuar rrokjet e fjalëve.

Sokoli ka lulë të kuqe .

Mami ka lule të kuqe.

4. Me fjalët e shpërndara ndërto me gojë një fjali.

Liria të kuqe lule ka

5. Lexo rrokjet e para të emrave poshtë figurave.



lule

lumë



kuti

kukull

SOKOLI LUAN ME TOP.

Sokoli luan me top.

Sokoli	luan	me top.

a A

Liria ka top të kuq.

Top të kuq ka dhe Sokoli.

Liria luan me top.

Dhe Sokoli luan me top.

USHTRIME

1. Qarko me laps të kuq shkronjën **i** dhe me laps blu shkronjën **u** në fletën e kontrollit.

2. Lexo fjalitë, duke plotësuar fjalët.

Sokoli ka top të kuq.

Top të kuq ka dhe Sokoli.

Sokoli .... me top.

3. Lexo fjalitë, duke plotësuar rrokjet e fjalëve.

Li..a ka top të kuq.

Top të kuq ka dhe Sok..li.

Li..a lu.. me top.

4. Lexo rrokjet e dyta të emrave poshtë figurave.

lumi

buka



muri

pema

barka

SOKOLI DHE LIRIA LUAJNË ME MAMIN.

Sokoli dhe Liria luajnë me mamin.

Sokoli	dhe	Liria	luajnë	me mamin.

Li ri a

a

a A



Liria, mami dhe Sokoli luajnë.

Mami, Liria dhe Sokoli luajnë me top.

Topin e ka Liria.

USHTRIME

1. Qarko me laps të kuq shkronjën **a** dhe me laps blu shkronjat **i** dhe **u** në fletën e kontrollit.

2. Lexo fjalitë, duke plotësuar fjalët.

Sokoli dhe Liria luajnë me top.

Liria dhe Sokoli luajnë me top.

Topin e ka Liria .

3. Lexo fjalitë, duke plotësuar rrokjet e fjalëve.

Sokoli dhe Liria luajnë me top.

Liria dhe Sokoli luajnë me mamin.

4. Me fjalët më poshtë ndërto një fjali:

me top Sokoli dhe Liria luajnë

5. Vizato në fletore:

një lule të kuqe

një top të kuq

RIMI UJIT LULET.

Rimi ujit lulet.

Rimi | ujit | lulet.

Ri | mi

Ri

R

ri - Rimi - ari - ariu

ra - ara - ura - Mira

R r

Rimi ujit lulet.
Miri ujit lulet.
Mira ujit lulet.

Miri luan me top.
Miri ka top me lule të kuqe.

USHTRIME

1. Qarko me laps të kuq shkronjën **r**, në fletën e kontrollit.

2. Lexo fjalitë, duke plotësuar fjalët.

Miri ujit lulet .

Rimi ujit lulet.

3. Lexo fjalitë, duke plotësuar rrokjet e fjalëve.

Miri ujit lulet .

Rimi ujit lulet.

4. Me fjalët e shpërndara ndërto një fjali.

lulet Miri ujit

5. Bëji edhe ti vizatimet dhe shkruaj nën to emrat përkatës.



6. Lexo rrokjet e dyta të emrave poshtë figurave.

ora

dora

dera

RIMI MBOLLI NJË LULE TË BUKUR.

Rimi mbolli një lule të bukur.

Rimi | mbolli | një | lule | të bukur.

lu | le

le

e

e E

e - era

le - lule

re - e re

Rimi ka lule.

Ai ka lule të bukura.

Rimi mbolli një lule të re dhe të bukur.

Miri e Rimi kanë lule me erë.

USHTRIME

1. Qarko me laps të kuq shkronjën **e** ne fletën e kontrollit.

2. Lexo fjalitë, duke plotësuar fjalët.

Rimi ka lule.

Ai ka lule të bukura.

Rimi mboll një lule.

2. Lexo fjalitë, duke plotësuar rrokjet e fjalëve.

Ri ka lu .

Rimi mbolli një lu të re.

4. Shqipto emrat e figurave dhe thuaj ç'tingull dëgjon në fillim.



ELEFANTI

ROSSA.

ARIU.

UCU.

5. Tek emrat poshtë figurave lexo dhe shkruaj në fletore vetëm rrokjet që fillojnë me shkronjën **r**:

gërshëra

lepuri

reja

piruni

MIRI E MIRA LUAJNË ME MAKINË.

Miri e Mira luajnë me makinë.

Miri | e | Mira | luajnë | me | makinë.

Mi | ri

Mi

M

M m

ma - mami - mali - mani - makinë
mi - Miri - Rimi - miu - lumi
mu - muri - mua

Miri ka një makinë.
Ai ka makinë të kuqe.
Miri e Mira luajnë me makinë.
Miri ka makinë të bukur.

Lexo fjalët më poshtë dhe pastaj kopjoji në fletore.

ara era ura ariu

USHTRIME

1. Qarko me laps të kuq shkronjën **m** në fletën e kontrollit.

2. Lexo fjalitë, duke plotësuar fjalët.

Miri ka ..... .

Ai ka makinë të .... .

Miri e ..... luajnë me makinë.

3. Lexo fjalitë, duke plotësuar rrokjet e fjalëve.

Mi.. ka ma..në.

Miri e Mi.. lu..në me maki.. .

4. Bëj këto vizatime dhe shkruaj nën to emrat.





muri

miu

5. Tek emrat poshtë figurave lexo vetëm rrokjet ku gjendet shkronja **m**, dhe thuaj në cilat fjalë i ke lexuar.



shamia

pema

mulliri

MARA BËRI ME RËRË NJË MAL.

Mara bëri me rërë një mal.

Mara	bëri	me	rërë	një	mal.

mal

l L

li - Liria - lima - mali - lliri

lu - lule - lumë - luajnë - Luli

le - lule - Leka

Në lumë

Mara dhe Luli luajnë me rërë.

Mara bëri me rërë një mal.

Luli bëri me rërë një urë.

li lu la le

lima mali lule lumi

SOKOLI ËSHTË ULUR NË URË.

Sokoli është ulur në urë.

Edhe Luani është ulur në urë.

Liria e Leka janë ulur në rërë.

USHTRIME

1. Qarko me laps të kuq shkronjën **l** në fletën e kontrollit.

2. Lexo fjalitë, duke plotësuar fjalët.

Luani .... ulur .. urë.

Liria e .... janë .... në rërë.

3. Lexo fjalitë, duke plotësuar rrokjet e fjalëve.

Lua.. bë.. me rërë një urë.

Li..a bë.. një mal.

ANI, ANILA DHE LUANI LUAJNË ME TOP.

Ani, Anila dhe Luani luajnë me top.

Ani,	Anila	dhe	Luani	luajnë	me top.

A ni

ni

n

n N

ni - Ani - Eni - Anila - Luani

na - Ana - mana - Lana

Luajnë me top

Ani, Anila dhe Luani luajnë me top.
Ani dhe Anila kanë top të kuq.
Luani ka top të bukur.
Luani dhe Anila luajnë mirë me top.
Edhe Ani luan mirë.

USHTRIME

1. Qarko me laps të kuq shkronjën **n** dhe me laps blu shkronjën **i** në fletën e kontrollit.

2. Lexo fjalitë dhe shkruaji në fletore.

Anila luan.

Ani luan.

ni	nu	na	ne

3. Tek emrat poshtë figurave lexo vetëm rrokjet që kanë shkronjën **l**.

valixhe


bizele

lugë

lakër

4. Tek emrat poshtë figurave lexo vetëm rrokjet që kanë shkronjën **n**.

manushaqja

majmuni

balona

peneli

5. Lexo fjalitë, duke plotësuar fjalët.

Ani, Anila dhe ..... luajnë .. top.
Luani .. top të bukur.

6. Lexo fjalinë, duke plotësuar rrokjet e fjalëve.

Lua.. dhe Ani.. luaj.. mirë me top.

UNË JAM NË KLASË TË PARË.

Unë jam në klasë të parë.

Unë	jam	në	klasë	të	parë.

U në

në

ë

ë Ë

në - unë - janë - kanë - nëna - luajnë

më - lumë - limë

rë - rërë - urë - arë - erë

Klasa e parë

Unë jam në klasë të parë.

Edhe Anila është në klasë të parë.

Në klasë ka lule të bukura.

Anila mbolli një lule të re.

Klasë me lule

Ani dhe Anila janë në klasë të parë.
Klasa është e bukur.
Në klasë kanë lule me erë të mirë.
Anila mbolli një lule të re.

USHTRIME

1. Qarko me laps të kuq shkronjën **ë** në fletën e kontrollit.

2. Lexo fjalitë, duke plotësuar fjalët.

Ani dhe ..... janë në ..... të parë.
Në klasë .... lule me ... të mirë.

3. Lexo fjalinë, duke plotësuar rrokjet e fjalëve.

A..la mbo.. një lu.. të bu... .

4. Me shkronjat e para të emrave të figurave formo një fjalë dhe shkruaje.




5. Lexoji fjalët më poshtë dhe kopjoji.

lumë urë erë arë
Ana Anila Neri

PËRSËRITJE

Fjalë që kanë shkronja ende të pamësuara:

Sokoli - dhe - kanë - një - të kuqe - ka - top - luajnë
ujit - luleˆt - mbolli - bukur - të bukura - makinë - bëri
jam - klasë - të parë - klasa - është

Zanore të mësuara: **i u a e ë**

Bashkëtingëllore të mësuara: **n m r l**

---

ri ru ra re rë	ri ru ra re rë
ni nu na ne në	ni nu na ne në
mi mu ma me më	mi mu ma me më
li lu la le lë	li lu la le lë

A N M

---

ura - urë	ara - arë	era - erë	lumi - lumë
mi - miu	ari - ariu	mal - mali	

mami - Liria - Sokoli - Rimi - Mira - Miri - Marini

kanë - lule - dhe - ka - të kuqe - luajnë - luan

mami, Liria dhe Sokoli

Liria dhe Sokoli kanë lule.

Sokoli ka një lule.

Miri ka lule të kuqe.

Sokoli luan me top.

Liria ka top të kuq.

Sokoli dhe Liria luajnë me mamin.

Ana luan.

Ani luan me rërë.

• Lexo fjalitë duke plotësuar.

Miri .... me top.

Anila .. një lu.. .

Miri .... lulet.

Liria ka ... të kuq.

• Lexo fjalitë duke plotësuar rrokjet e fjalëve.

Mi..la ka lu.. të kuqe.

Mi.. ka top me lu.. të ..qe.

MIRA DHE LEKA SHKUAN NË MAL.

Mira dhe Leka shkuan në mal.

Mira	dhe	Leka	shkuan	në mal.

Le ka

ka

k

k K

ka - kanë - kalë - kala - kaluan

ku - miku - leku - iku

ke - kemi - keni

ki - kinema - makinë

unë kam - ti ke - ai ka ne kemi - ju keni - ata kanë

Kalë i bukur



Leka e Mira kanë një kalë të bukur.
Kali e ka emrin Kleni.
Mira e Leka shkuan me Klenin
në një fshat malor.
Fshati ku shkuan Mira e Leka, është
i ri dhe i bukur.

Fshat malor

- Sokol, ku kanë ikur Mira e Leka?
- Mira e Leka, Liri, kanë ikur
në një fshat malor.
Fshati ku ikën Mira e Leka,
ka klimë të mirë.
Ai fshat ka dhe një lumë.

USHTRIME

1. Qarko me laps të kuq shkronjën **k** në fletën e kontrollit.

2. Bëji vizatimet dhe shkruaj nën to emrat përkatës.

makinë
karamele

3. Lexo fjalitë, duke plotësuar rrokjet e fjalëve.

Leka e .... kanë një ... të bukur.
Kali e ka .... Kleni.

4. Lexo fjalitë, duke plotësuar rrokjet e fjalëve.

Mira e Le.. shku.. në një fshat ma...
Fsha.. ka kli.. të mirë.

5. Ndërto fjali me fjalët e mëposhtme:

të mirë fshati klimë

BABAI I SOKOLIT PUNON NË MINIERË.

Babai i Sokolit punon në minierë.

Babai	i Sokolit	punon	në minierë.

pu non

pu

p

p P

pa - pak - kapak - para - përpara - riparon
pu - punon - pula - pulari - pupla
pe - pemë - pema - perime - peri

Babai i Sokolit

Babai i Sokolit punon në minierë.
Në minierë punon dhe babai i Lirisë.
Babai i Sokolit punon mirë.
Mirë punon dhe babai i Lirisë.
Sokolin e Lirinë i mori babai i Sokolit
me makinë për të parë minierën.

ra - pra	la - pla
ru - pru	lu - plu
re - pre	le - ple
ri - pri	li - pli

BABAI I SOKOLIT PUNON NË MINIERË.

Babai i Sokolit punon në minierë.

Babai	i Sokolit	punon	në minierë.

pu non

pu

p

p P

pa - pak - kapak - para - përpara - riparon
pu - punon - pula - pulari - pupla
pe - pemë - pema - perime - peri

Babai i Sokolit

Babai i Sokolit punon në minierë.
Në minierë punon dhe babai i Lirisë.
Babai i Sokolit punon mirë.
Mirë punon dhe babai i Lirisë.
Sokolin e Lirinë i mori babai i Sokolit
me makinë për të parë minierën.

ra - pra	la - pla
ru - pru	lu - plu
re - pre	le - ple
ri - pri	li - pli

Në pulari

- Mira, ku të punon mami?
- Mami im, Mirela, punon në pulari.
Në pulari ka pula me pupla të bukura.
- Po babi ku të punon?
- Babi im është mekanik. Ai riparon makina. Babi shkon në punë me makinë.

USHTRIME

1. Vizatoji edhe ti. Shkruaj nën vizatime emrat.



2. Fjalinë më poshtë shkruaje në fletore.

Në pulari ka pula.

. Radhiti fjalët për të ndërtuar fjali.

Mami • në • punon • im • pulari.

ELONA BËRI KURORË ME LULE.

Elona bëri kurorë me lule.

Elona	bëri	kurorë	me lule.

E	lo	na

lo

o

o O

o - ora - orë - orar - orari

lo - Elona - lopa - lopë - lopar

no - Nora - puno - punon

ko - koka - kokë - pako

ro - kurorë - kurora

Elona bëri një kurorë me lule

Elona bëri një kurorë me lule.

Edhe Nora bëri kurorë me lule.

Kurorën me lule Elona e ka në kokë.

Kurorë me lule ka në kokë edhe Nora.

Elona e Nora kanë në kokë kurora me lule.

Elona ka në kokë kurorë me lule.

Lule për mamin dhe për babin

Elona këputi një lule dhe i mori erë.

Edhe Nora i mori erë.

Nora dhe Elona kanë në kokë kurora me lule me erë të mirë.

Elona mori lule dhe për mamin, dhe për babin.

Edhe Nora mori lule për mamin dhe për babin.

USHTRIME

1. Qarko me laps të kuq shkronjën **o** dhe me laps blu shkronjën **p** në fletën e kontrollit.

2. Bëj vizatimet dhe shkruaj nën to emrat.

orë
limon
kamion

3. Lexo fjalitë, duke plotësuar fjalët.

Elona bëri një ..... me .... .

Kurorën Elona e ka në .... .

4. Lexo fjalitë, duke plotësuar rrokjet e fjalëve.

Elo.. dhe No.. kanë në ko.. kurora me lule.

Elona dhe ..ra morën lu.. për ma... dhe për babin.

5.Fjalët poshtë figurave lexoji dhe kopjoji.

lopë kapelë top karotë

TIRANA ËSHTË E BUKUR.

Tirana është e bukur.

Tirana	është	e bukur.

Ti	ra	na

Ti

T

t T

ti - Tirana - Tiranë - moti
tu - tunel - tuneli - tunele
tri - metri - ketri - triko
tre - treni - tren
tra - trari - letra - motra

ti tu ta to te të

Teuta iku në Tiranë

- Mami, ku iku Teuta?
- Teuta iku me babin në Tiranë.
- Me tren, mami?
- Po, Titi, me tren.
- Kanë kaluar tunele?
- Kanë kaluar tri tunele.

tri tru tra
tre tro trë

Në Tiranë Teuta ka motrën.
Teuta iku te motra.

Treni i Tomorit

Tomori ka një tren të bukur.
Treni i Tomorit është i kuq.
Tomori luan me Teutën me tren.
Treni tani po kalon në tunel.
Tuneli nuk është i lartë.

USHTRIME

1. Bëj vizatimet dhe shkruaj nën to emrat.





lopatë
patate
tren

2. Vizato dhe nën vizatime shkruaj emrat përkatës.

top + karotë + kuti

3. Plotëso fjalinë dhe shkruaje në fletore.

Artani punoj me lopatë.

4. Lexo fjalët dhe kopjo ato që kanë rrokjen **tri**.

trupi trimi treni metri

BALONA E BENIT.

Balona e Benit.

Balona | e Benit.

Ba | lo | na

Ba

B

B b

ba - balona - babi - babai

bi - bima - biba - kubi

ble - bleta - Blerti - Blerta - Blerimi



Balona e Benit

1. - Beni, a të bëri babi balonë?
   - Po, Blerim, më bëri. Më bëri një balonë të bukur.
   - Edhe mua babi më bëri një balonë të bukur.
2. Beni e Blerimi po luajnë me balonë. Balona e Blerimit e kaloi balonën e Benit.

ba bo bu be bë bi

Beni luan me kube

1. - Babi, a luajmë me kube?

   - Mirë, Beni, luajmë. Po kubet ku i kemi?

   - Këtu, babi, këtu në kuti.

2. Beni me babin bënë me kube një urë të bukur.

Beni luan me kube edhe me Blerimin.

USHTRIME

1. Qarko me laps të kuq shkronjën **b** në fletën e kontrollit.

2. Bëji edhe ti vizatimet dhe shkruaj nën to emrat.



balonë
bukë
barkë

3. Radhit fjalët për të ndërtuar fjali.

Beni urë të bukur bëri me kube një

4. Plotëso me mend fjalinë dhe shkruaje në fletore.

Ble.... ka ba..në të bu... .

5. Lexo fjalinë më poshtë dhe shkruaje pa e parë.

Beni luan me kube.

NË OBORR KA BORË.

Në oborr ka borë.

Në	oborr	ka	borë.

o	borr

borr

rr

rr Rr

ra - ara - arë

rra - arra - arrë

rri - korriku - oborri

rro - rrota - rroba

rre - rrepa

Luajnë me borë

1. - Urra! Urra! Po bie borë!

- A luajmë në oborr me borë, Blerta?

- Mirë, Tomor, luajmë.

2. Tomori dhe Blerta luajnë në oborr me borë. Ata bënë një burrë bore.

Blerta i vuri një kapelë në kokë dhe Tomori një karotë.

Arbeni punon me lopatë.
Blerimi punon me bel.
Blerta punon me karro.
Në karro ka karota e rrepa.

USHTRIME

1. Lexo tekstin më sipër. Trego se në cilat fjalë është përdorur shkronja **r** dhe në cilat shkronja **rr**.

2. Gjej tri fjalë me tingullin **r** dhe tri fjalë me tingullin **rr**; shqiptoji që të shquhet mirë dallimi ndërmjet **r** dhe **rr**.

3. Bëj këto vizatime dhe shkruaj nën to emrat.



karro
rrepë
rrotë

4. Fjalët më poshtë lexoji disa herë pa zë dhe pastaj me zë:

ara - arra rrota - rroba burri bariu karota

5. Plotëso fjalinë dhe shkruaje.

Blerta bleu . .

SOKOLI MËSON MIRË.

Sokoli mëson mirë.

Sokoli	mëson	mirë.

So	ko	li

So

S **S s**

sa - rosa - Besa - sapuni

su - supa - supi - mësuesi

si - kosi - lapsi - mësimi

so - soba - Sokoli - mësoni

so si su

së sa se

Sokoli mëson mirë

1. - Nesër, mami, kam për të mësuar me Sokolin. Sokoli mëson mirë.

2. - Mirë, Besa, mëso me Sokolin. Sokoli është i mirë. Pasi të mbaroni mësimet, luani në oborr. Dhe unë kam për të bërë një supë të mirë me karota, rrepa e patate, si dhe një tortë të mirë me arra.

Mësuesja jonë



1. Ne kemi një mësuese shumë të mirë. Atë e kemi si mamin tonë.

2. Mësuesja jonë, në orën e mësimit, nuk rri kurrë ulur. Ajo na mëson shumë mirë. Sot pruri në klasë një tabelë të bukur për mësimin e abetares.

Në muret e klasës kemi punimet tona.

USHTRIME

1. Bëj këto vizatime dhe shkruaj nën to emrat.

tas
sapun
saksi

2. Shkruaj në fletore emrat që të kujtojnë figurat.

3. Duke parë figurën, plotëso dhe shkruaj në fletore.

Besniku po kosit lulen.

HEKTORI PO MËSON TË HEKUROSË.

Hektori po mëson të hekurosë.

Hektori	po mëson	të hekurosë.

He	kto	ri

He

H **H h**

h - leh - pleh - krah - kreh

he - herë - herët - hekur - hekuros - helikopter

hu - lahu - lahuni - krihu - krihuni

hë - hëna - hënë - e hënë - kohë - kohën

Hektori bën punë

1. Hektori nuk e kalon kohën kot.
Në kohë të lirë ai merret me punë.
Mami i rri pranë dhe e mëson.
Sot, Hektori po mëson të hekurosë.

2. Babai i Hektorit është pilot.
Me helikopter, ai pruri një të sëmurë
për ta operuar në spital.



Hektori mësoi të hekurosë
Sot, mami i Hektorit iku herët në punë.
Hektori hekurosi përparësen e Teutës.
Teutën Hektori e ka motër.

USHTRIME

1. Bëj vizatimet dhe shkruaj n[illegible]rat.





hënë
krehër
hekur

2. Për secilën fjalë krijo nga një fjali.

hahet	pihet	lahet	krihet
lahem	lahen	krihem	krihen

3. Me fjalët e çdo rreshti ndërto dy fjali:

- e mësoi Hektorin të hekurosë Mami
- kohë Sot të mirë kemi

PËRSËRITJE

1. Fjalë që kanë shkronja ende të pamësuara:

një - fshat - riparon - është - dhe - janë

vuri - mësuesja - jonë - e kuqe - mbolli

2. Zanore të mësuara: **i u a e ë o**

Bashkëtingëllore të mësuara: **k p t b rr s h**

3. Rrokje të ushtruara:

ki	ku	ka	ke	kë	ko
pi	pu	pa	pe	pë	po
ti	tu	ta	te	të	to
bi	bu	ba	be	bë	bo
rri	rru	rra	rre	rrë	rro
si	su	sa	se	së	so
hi	hu	ha	he	hë	ho



4. Shkronja të ushtruara:



5. kam - ke - ka mësim - mëson - mësuese

kemi - keni - kanë kinema - makinë - mekanik

riparon - punon - minierë

punë - puno - punoi
këto - këtu - këtë
kor - korr - oborr

mëso - mësoni - mësoi
ke - kemi - keni
sobë - rrobë - rrotë

urim - burim - buron - kalon
not - noto - noton - punon
ra - pra - prapë - prapa
ka - kanë - kala - kaluar

Leka dhe Mira kanë një kalë të bukur.
Babai i Sokolit punon në minierë.
Mara me Elonën mblodhën lule.
Tomori luan me tren të kuq.
Beni e Blerimi po luajnë me balonë.
Tomori dhe Blerta bënë burrë bore.

SHPRESA DHE SHPËTIMI

Shpresa dhe Shpëtimi

Shpresa | dhe | Shpëtimi

Shpre | sa

Shpre

Sh

Sh sh

shk - shkollë - pushkë - shkumës - shkop - peshk

shp - shpatë - shportë - Shpresa - Shpëtim

sht - është - poshtë - shtëpi - kashtë - shtatë - shtrat

sho shi sha she shu shë

1. Shpresa dhe Shpëtimi janë shokë. Shpëtimi është në klasën e parë. Shpresa është në klasën e tretë.
2. Kur mbaruan mësimet, po binte shi. Shpëtimi nuk e kishte mushamanë. Ai u mbulua me mushamanë e Shpresës.

Shiu pushoi

-Babi, a ka për të rënë më shi?

-Nuk më besohet, Shpëtim. Shiu pushoi. Re nuk po shihen. Sonte kemi për të pasur natë me hënë.

USHTRIME

1. Bëj vizatimet dhe shkruaj nën to emrat.



sharrë

peshore

2. Vizato dhe shkruaj emrat nën vizatime.

shtëpi shportë peshk

3. Ndërto fjalinë sipas figurës dhe shkruaje në fletore.

Shpresa.....

Bleta na jep mjaltin

1. Babai i Kreshnikut është rritës bletësh. Në kopshtin e shtëpisë ata kanë shtatë koshere me bletë.

2. Ai sot mori Kreshnikun për të parë kosheret.

-Shiko, Kreshnik, ato janë koshere, shtëpi blete. Në to banon bleta. Ajo kullot lule më lule dhe na jep mjaltin e ëmbël. Bleta, Kreshnik, është shumë punëtore.

USHTRIME

1. Fjalinë më poshtë kopjoje dy herë dhe shkruaje pa e parë.

Bleta është shumë punëtore.

2. Radhit fjalët më poshtë për të ndërtuar një fjali:

e ëmbël na Bleta mjaltin jep

3. Lexo dhe krahaso përbërjen e fjalëve:

shko - shkoi shtro - shtroi

shiti - shati shtati - shtrati

Në vreshtë

Shpresa me babin shkuan sot në vreshtë. Ata mbushën tri shporta me rrush. Rrushi ishte shumë i ëmbël. Shpresa e ha shumë rrushin.

Mami i Shpresës bëri musht dhe e shtiu në shishe.

USHTRIME

1. Në tekstin e mësipërm lexo edhe një herë fjalët dyrrokëshe.

2. Me rrokjet më poshtë formo katër fjalë dhe shkruaji ato.

shko pe ma ka
shku të shta pi

3. Formo katër fjalë dyrrokëshe me: **pre, pu, pru, ko,** duke u shtuar prapa rrokjen **shi**. Shkruaji ato.

4. Shqipto emrat që të kujtojnë figurat, dhe shkruaji në fletore.



ERVINI DHE VALBONA JANË SPORTISTË.

Ervini dhe Valbona janë sportistë.

Ervini	dhe	Valbona	janë	sportistë.

Er vi ni

vi

v **v V**

va - vapa - vapori - Etleva - kova - Kosova
vi - viti - violina
ve - pranvera - vera - vesa
vr - vrapova - vrapove - vrapoi
vrapuam - vrapuat - vrapuan

vu va vi ve vo vë

Janë sportistë



1. Ervini me Valbonën janë shokë. Ata janë në klasë sportive. Valbona dhe Ervini kanë trup të bukur.
2. Valbona është vrapuese e mirë, kurse Ervini merret më shumë me lojëra me top. Edhe në vrapim Ervini është i mirë.
3. Valbona merr mësim edhe në violinë. Valbona dhe Ervini janë shumë mirë në mësime.

Pushimet verore

Valbona dhe Ervini shkuan për verim në Vlorë. Këtë verë Valbona dhe Ervini notuan për herë të parë në det. Notin e kishin mësuar në lumë. Në det ata shëtitën me vapor dhe me barkë me vela. Në Vlorë, Valbona dhe Ervini e kaluan shumë mirë.

USHTRIME

1. Vizatoji edhe ti dhe shkruaj nën to emrat përkatës.

tavë
violinë
barkë

JETA DHE BUJARI JANË NË NJË KLASË.

Jeta dhe Bujari janë në një klasë.

Jeta	dhe	Bujari	janë	në	një	klasë.

Je	ta

Je

J **J j**



ja - Bujari - jam - janë - jashtë - jakë

je - Jeta - jemi - jeni - hoje

aj - luaj - shkruaj - muaj

oj - banoj - vrapoj - shikoj - numëroj punoj - mësoj

20 fjalë

Shtëpia e re

1. Babai i Bujarit po bën një shtëpi të re. Pas një muaji, në janar, shtëpia do të jetë e mbaruar. Vitin e Ri ata do ta festojnë në shtëpinë e re.
2. Babai i Bujarit ka blerë mobilie të reja dhe të bukur
3. Bujari me Jetën mësojnë bashkë. Ata janë shokë klase.

Klasa e Jetës

1. Jeta është në klasën e tretë. Në klasën e saj ka nxënës shumë të mirë. Ata mësojnë mirë dhe shkruajnë bukur.
2. Kohën e pushimit e kalojnë në oborrin e shkollës. Ata luajnë me litar dhe me peta.

Ali mue

USHTRIME

1. Bëj këto vizatime dhe shkruaj nën to emrat.



jakë
jastëk
pjeshkë

2. Fjalinë më poshtë shkruaje të plotësuar.

Bujari e Jeta. mësojnë bashkë.

3. Ç'emra të kujtojnë figurat? Shkruaj dy fjalë, duke radhitur rrokjet e para të tyre.

NJË DITË ME DIELL

Një ditë me diell

Një	ditë	me	diell

di	ell

ell

ll ll Ll

lla - pulla - tulla - shkolla - përralla

lli - ulliri - kalliri - mulliri

llë - mollë - shkallë - shkollë - pullë - tullë

Në kopshtin me pemë

1. Ishte ditë e bukur me diell. Bashkë me mësuesen shkuam në një kopsht. Kopshtari kishte mbjellë mollë, kumbulla, portokalle dhe lloj-lloj pemësh të tjera.

2. Në një pemë kishte mbështetur një palë shkallë. Shkallët i kishte për të vjelë pemët.

3. Kur po iknim, ai na mbushi një shportë me kumbulla.

Shëtitje në fshat

1. - Babi, ne sot bëmë shëtitje në një fshat. Atje kishte lloj-lloj pemësh. Sa të bukura ishin serrat e mbjella me perime!

Uji binte mbi sallatë si shi.

2. Pranë serrës po kullotnin lopë laramane. Për herë të parë unë pashë sallë lopësh.

- Jo, Arben, ti atje nuk ke parë sallë, po stallë lopësh.

- Po, babi, po, stallë, se harrova.



USHTRIME

1. Bëj këto vizatime dhe poshtë tyre shkruaj emrat.

mollë
kukull
llambë

2. Vizato dhe shkruaj nën to emrat:

pantallona shall shkallë

3. Fjalët më poshtë lexoji, krahasoji dhe shkruaji:

pula - pulla, mali - malli, kali - kalliri

4. Shkruaj një fjali ku të përdorësh fjalën **kullot**.

DËSHIRAT TONA

Dëshirat tona

Dëshirat | tona

Dë | shi | rat

Dë

D

D d

dri - drita - dritare - Drita

dre - dreka - dreri

dru - druri

dra - kodra - lodra - drapri

Dëshirat tona

-Unë, mësuese, kur të rritem, dëshiroj të bëhem mësuese si ju.

-Po ti, Ardi ?

-Unë dua të bëhem detar, që të shoh shumë vende të botës. Diana dëshiron të bëhet dentiste. Shpendi do të bëhet aviator, që të shohë nga lart bukuritë e rralla të vendit tonë.



T'ju ndihmoj ?

1. Teta Drita, t'ju ndihmoj unë?
   - Jo, Dritan, nuk më ndihmon dot, se rrjeta është shumë e rëndë.
   - E mbajmë me një dorë unë dhe me një dorë ju.
   - Kështu po.
2. Dritani e ndihmoi teta Dritën deri te dera e shtëpisë.

USHTRIME

1. Bëj këto vizatime dhe shkruaj nën to emrat.



derë
perde
dritare

2. Vizato dhe shkruaj nën to emrat:

diell dorë domate

3. Lexoje fjalinë pa zë, kopjoje disa herë dhe shkruaje pa e parë.

Dielli na bën mirë.

PËRSËRITJE

sha	shi	shu	sho	she	shë
shka	shki	shku	shko	shke	shkë
shta	shti	shtu	shto	shte	shtë
va	vi	vu	vo	ve	vë
vra	vri	vru	vro	vre	vrë
da	di	du	do	de	dë
dra	dri	dru	dro	dre	drë

sharra - shalli - koshi - veshi - rrushi - java
shamia - llokumi - mulliri - kullota - vetulla
muaji - vapori - dimri - shikova - shikove - shikoi

dollap - llokum - mullar - vetull - dimër - pallat
vapor - darkë - bidon - sharroj - sharron - shikon

shkolla - shkalla - mushka - preshi - prushi - gushti
kodra - lodra - druri - drita - dreka - vatra - shkopi

shkrimi - shkruaj - shkruan - vjeshta - shtrati
peshku - shtresa - Shpresa - shkurti - shporta

Dallo ndryshimet:

- kollë - mollë - shkollë - shkallë
- presh - prush - prish
- vjeshtë - vreshtë
- dita - drita - dritare - dritarja
- shtat - shtatë - shtati - shtrati

Lexo fjalitë:

1. Unë shkruaj me kujdes.
   Shkrimi im është i bukur.
2. Java ka shtatë ditë.
   Muaji ka katër javë.
   Viti ka katër stinë.
   Stinët e vitit janë: pranvera,
   vera, vjeshta, dimri.

TRI TUFA ME LULE

Tri tufa me lule

Tri | tufa | me lule

tu | fa

fa

f **f F**





fa - fabrikë - farkëtar

fe - festojmë - festoni - festojnë

fl - flamur - fletore - flutur

fj - fjalë - fjali - fjalim

Tri tufa me lule

1. Ishte ditë e bukur pranvere. Flutura me Fatosin dhe Afrimin bënë një shëtitje të bukur.

2. Ata ndaluan në një fushë që ishte plot me lule. Flutura filloi e para të mblidhte lule. Ajo bëri me ato një kurorë dhe e vuri në kokë. Afrimi bëri një tufë me lule. Fatosi mblodhi më shumë. Ai bëri tri tufa: një për mamin, një për babin dhe një për mësuesen.

Flori dhe flutura

1. Flori po luante në oborrin e shtëpisë, që ishte plot me lule të bukura.
2. Afër Florit, fluturoi një flutur dhe u ndal në një trëndafil të kuq.
3. Flori donte ta kapte fluturën, prandaj iu afrua duke kënduar:

"Flutur-flutur babare,
bjer përdhe ..."

Mirëpo Flori nuk arriti ta kapte, se flutura fluturoi në një trëndafil tjetër.

USHTRIME

1. Bëj dhe ti vizatimet dhe shkruaj nën to emrat.

flakë
fustan
fletore



2. Vizato dhe shkruaji emrat poshtë vizatimeve:

flamur flutur fshesë

3. Shkruaj një fjali duke radhitur rrokjet e para të emrave të figurave më poshtë.



BURBUQJA ME SHQIPEN

Burbuqja me Shqipen

Burbuqja | me Shqipen

Bur | bu | qja

qja

q

q Q

q - fiq - miq - piq- hiq

shq - shqip - Shqipëri - shqiptar

shqep - shqepim - shqepni

qe - qesh - qershi - qershor

Në teatrin e kukullave

1. Burbuqja me Shqipen shkuan në teatrin e kukullave për të parë "Pinokun".
2. Që në fillim të shfaqjes, Shqipja filloi të qeshte.
   - Shqipe, mos qesh kaq shumë, se na prish qetësinë.
3. Shqipes i pëlqen shumë teatri i kukullave.
   Shqipja me Burbuqen u kënaqën shumë nga shfaqja.

USHTRIM

Formo nga një fjali me fjalët: **Shqipëri, shqip** dhe **shqiptar**. Shkruaji fjalitë.

Qershitë

1. Mami solli në shtëpi një qeskë me qershi. Ajo e di se Shqipes i pëlqejnë shumë qershitë. Mbushi një pjatë dhe ia vuri Shqipes përpara.

2. Qershitë ishin të pjekura mirë, të kuqe dhe të ëmbla. Shqipja i hëngri me kënaqësi. Ajo falënderoi mamin për qershitë që i solli.

- Të pëlqyen, Shqipe?

- Po, mami, më pëlqyen shumë. Ishin shumë të mira.

USHTRIME

1. Bëj këto vizatime dhe shkruaj emrat poshtë tyre



peshq
fiq
qershi

2. Lexoje fjalinë pa zë dhe shkruaje pa e parë.

Shqipëria ka shumë miq në botë.

DHURATA UDHËTON ME TREN.

Dhurata udhëton me tren.

Dhurata	udhëton	me tren.

Dhu	ra	ta

Dhu

Dh

Dh dh

dhj - dhjetë - dhjetor - mbledhje

dhe - dhen - dhelpër - dhelpra

dhë - dardhë - udhë - hekurudhë

dha - dhallë - dardha - kërpudha - rrudha

dha dhu dhi dhe dhë dho

Dhurata me Bardhin udhëtojnë me tren

1. Dhurata me Bardhin po udhëtonin me tren. Bardhi kishte marrë me vete një kokërr dardhë. E qëroi atë dhe e ndau në dy pjesë. Më të madhen ia dha Dhuratës.
2. Dhurata e falënderoi Bardhin, por nuk i erdhi mirë, kur pa se lëkurat ai i hodhi përdhe.
3. Bardhi, i turpëruar, i mblodhi lëkurat dhe i futi në një qeskë.

Bardha te dentistja

1. - Nuk të shoh të qetë, Bardha.

- Më dhemb një dhëmb, mësuese.

- Duro edhe pak, sa të mbarojë mësimi.

2. Pas mësimit, mësuesja e dërgoi Bardhën te dentistja.

3. Dentistja ia mbushi dhëmbin Bardhës pa dhimbje fare.

USHTRIME

1. Bëj vizatimet dhe shkruaj nën to emrat.

dhi
dhelpër
hudhër

2. Vizato dhe shkruaj nën to emrat.

dardhë kërpudhë

3. Lexoje fjalinë pa zë, kopjoje disa herë dhe shkruaje pa e parë.

Dhëmbët i laj përditë.

YLLKA ME YLLIN JANË SHOKË.

Yllka me Yllin janë shokë.

Yllka	me	Yllin	janë	shokë.

Yll	ka

Yll

Y

Y y

y - yll - Ylli - ylberi

py - pylli - pyje

dy - dyllë - dysh - dyshek

dry - dryni

shty - shtylla

mby - e mbylla - e mbylle - e mbylli



28

Yllka me Yllin

- Yllka, a e bëre detyrën e shkrimit?

- Po, Ylli, e bëra. Kam shkruar fjalët: yll, pyll, dyllë, fyell, ylber, shtyllë, Bardhyl. Me shkronjën Y kam shkruar emrin tim dhe emrin tënd.

- Edhe unë, Yllka, do të shkruaj fjalinë: "Yllka me Yllin janë shokë."

Shokët

1. Dje Ylli nuk shkoi në shkollë. Ai kishte dhembje në fyt.

Sot i shkuan shokët në shtëpi. Yllka qëndroi pranë derës.

2. - Të lutem, Yllka, mbylle derën, se do të ftohesh.

Yllka mbylli derën dhe shkoi të mbyllte dhe dritaren.

- Jo, Yllka, dritaren mos e mbyll. Duhet të hyjë ajër i pastër.

USHTRIME

1. Bëj këto vizatime dhe shkruaj nën to emrat.

dallëndyshe
fyell
dry

2. Vizato dhe shkruaj nën to emrat.

yll pyll yllber

3. Formo një fjali sipas figurës dhe shkruaje në fletore.

..... **pemët**

MANJOLA DHE SONJA

Manjola dhe Sonja

Manjola	dhe	Sonja

Ma	njo	la

njo

nj

nj Nj

nj - ftonj - ullinj - kallinj - barinj

një - gështenjë - brinjë - shkronjë - rrënjë - fqinjë - shqiponjë

nji - njihem - njihesh - njihet - njihemi - njiheni - njihen

njo - njollë - banjo - i njomë - unë njoh - ti njeh - ai njeh

nja - Sonja - shkronja - gështenjë - shqiponja - fqinja

Manjola dhe Sonja

1. Manjola është në kopshtin e fëmijëve. Manjola është një fëmijë e pastër. Ajo duket si një kukull e bukur. Edhe rrobat i mban shumë pastër. Në to nuk shihet asnjë njollë.

2. Sonja është shoqja e ngushtë e Manjolës. Edhe Sonja është njësoj si Manjola.

Pas disa vjetësh

1. Një ditë Sonja pa në rrugë Manjolën. Iu afrua dhe e përqafoi me shumë mall.
2. - A nuk po më njeh, Manjola?
Unë jam Sonja. Kemi qenë në të njëjtin kopsht bashkë.
3. - Po, po, Sonja, më kujtohet. Ti vishje shpesh një bluzë të bukur, me një shqiponjë të madhe. Paske ndryshuar shumë! Qenke zbukuruar!

USHTRIME

1. Lexo në tekst vetëm fjalët që kanë shkronjën **nj**.

2. Bëj këto vizatime dhe shkruaj nën to emrat.



ullinj
penj
kallinj

3. Vizato dhe poshtë vizatimeve shkruaj emrat.

dy qirinj dy ullinj

AGRONI SHËNOI NJË GOL TË BUKUR.

Agroni shënoi një gol të bukur.

Agroni	shënoi	një	gol	të	bukur.

A	gro	ni

gro

g **g G**

g - lag - larg - varg - djeg - shelg - breg

gë - lugë - rrugë - degë - shegë - këngë - këngëtar

gr - grip - grup - grep - gropë - grurë - grusht

ng - ngut - ngul - trangull - ngroh

Goli më i bukur

1. Në oborrin e pallatit po luanin skuadra e Agronit me skuadrën e Agimit. Skuadra e Agronit kishte këta lojtarë: Yllin, Arditin, Durimin dhe Agronin. Kurse skuadra e Agimit kishte: Gentin, Gencin, Gurin dhe Agimin.

Për porta vunë nga dy gurë.

2. Skuadra e Agimit shënoi një gol, kurse skuadra e Agronit shënoi dy gola. Goli më i bukur qe i Agronit.



Gomari me lëkurë luani

1. Një gomar, i lodhur nga ngarkesa, u largua nga fshati dhe u fut në pyll. Në rrugë gjeti një lëkurë luani, e mori dhe e veshi.

2. Kafshët, kur e panë, i bënë shumë nderime dhe e gostitën me të ngrëna nga më të mirat. Gomari, pasi hëngri dhe u ngop mirë e mirë, filloi të pëlliste. Nga ky gabim që bëri, kafshët filluan ta goditnin me dru.

3. - Pse po silleni keq me mua? - u ankua gomari.

- Sepse doje të na gënjesh. Gënjeshtarët ne i urrejmë shumë.

USHTRIME

1. Bëj këto vizatime dhe shkruaj nën to emrat.



kalli gruri
vagon treni.
grep peshkimi

2.Lexoje pa zë dhe shkruaje pa e parë.

Mielli bëhet nga gruri.

TELEVIZORI

Televizori

Televizori

Te le vi zo ri

zo

z

z Z

za - zambak - vizatim - zarf

zo - gëzohem - gëzohesh - gëzohet

z televizor

zu - gëzuar - të lulëzuar

zi - vizitë - muzikë - muzikant - zile

Përpara televizorit

1. Zana kishte ndezur televizorin dhe po shihte një film vizatimor.
2. Gëzimi ndërroi stacionin, për të parë një ndeshje futbolli. Zana mori një libër dhe filloi të lexonte pa zë. Iu lut Gëzimit që t'ia ulte pak zërin televizorit.
3. Edhe mami i foli:

– Mirë e ka Zana, ule pak zërin.

Gëzimi u bind dhe ia uli zërin televizorit.

Festojmë Vitin e Ri



1. Po shtrohej tryeza e darkës së Vitit të Ri. Gëzimi dhe Zana e vogël ishin shumë të gëzuar. Gëzimi i tyre u bë edhe më i madh, kur mami u dha dhuratat e Vitit të Ri. Zana filloi të këndonte nga gëzimi dhe iu hodh mamit në qafë.
2. Mami, Babi dhe Gazmendi përqafuan Gëzimin dhe Zanën e vogël.
3. Mbrëmjen e Vitit të Ri e kaluan të gëzuar pranë tryezës, duke ngrënë e duke pirë, duke qeshur dhe duke parë televizor.

USHTRIME

1. Fjalinë më poshtë shkruaje të plotësuar.

Gë . . ar . . tin e Ri.

2. Vizatoji edhe ti dhe shkruaj nën to emrat:







televizor
fizarmonikë
zambak

GJYSHI NË GJIRIN E FAMILJES

Gjyshi në gjirin e familjes

Gjyshi | në gjirin | e familjes

Gjy | shi

Gjy

Gj

Gj gj



gja - gjak - gjashtë - gjarpër - i gjatë

gju - gjuhë - gjumë - gjurmë - gjunjë

gjy - gjym - gjysh - gjyshe - gjysmë

ngj - ngjit - ngjitem - ngjyrë - ngjalë

Gjyshi në gjirin e familjes

1. Në shkollë, Gjergji mëson gjuhën gjermane. Gjuhën angleze po e mëson në shtëpi me gjyshin.

2.Gjyshi i Gjergjit ka punuar gjithë jetën jashtë Atdheut. Ka gjashtë muaj që është kthyer përgjithmonë.

3. Gjyshi është shumë i gëzuar që gjendet në Atdheun e tij dhe jeton në gjirin e familjes, me mbesat dhe nipat që i do aq shumë.

Në dyqanin e lodrave

1. Gjyshi mori Gjinin e vogël me vete dhe shkuan te dyqani i lodrave.

– Gjin, zgjidh lodrën që të pëlqen më shumë.

– Këto lodra, gjysh, qenkan të gjitha të bukura!

2. Gjini zgjodhi një kuti. Brenda në të kishte forma të ndryshme me ngjyra.

Lodrën që ia bleu gjyshi, Gjini ua tregoi të gjithë shokëve.

CICËRIMAT E ZOGJVE

Cicërimat e zogjve

Cicërimat | e zogjve

Ci | cë | ri | mat

Ci

C

C c

ci - Genci - cicërima - keci

ce - mace - pecetë - tullumbace

cë - ngricë - salcë

co - copë - copëtoj

Cicërima zogjsh

1. Genci po bënte detyrat e shkollës. Në dritare ai dëgjoi cicërima zogjsh: ciu - ciu - ciu!

Zogjtë kërkonin ushqim, por nuk gjenin dot, se ishte ngricë e madhe. Gencit i erdhi keq. La punën, hapi dritaren dhe u hodhi zogjve ca grimca buke.

Babai e pa dhe e përgëzoi:

2. - Të lumtë, Genc! Zogjtë janë shumë të dobishëm. Ata hanë kandrrat e dëmshme. Ata na kënaqin me cicërimat e tyre.

DETYRË

Gjej dhe shkruaj fjalë që të kenë shkronjën **c**.

Dhia, cjapi dhe kecat

1. Kur po dilte për të gjetur ca ushqim, dhia i porositi kecat:

- Mos e hapni derën, po të mos shihni këmbën time të bardhë!

- Jo, mami, jo, - i thanë kecat.

2. "Tak, tak, tak" trokiti ujku në derë.

- Cili je ti? - thirrën kecat.

- Jam unë, mami. Hapeni derën!

- Na trego këmbën, ta shohim!

Ujku u tregoi këmbën, që e kishte të lyer me miell.

3. Cjapi, babai i kecave, që ishte në një cep të dhomës, u tha kecave:

- Mos e hapni derën, se është ujku.

USHTRIME

1. Bëj këto vizatime dhe shkruaj nën to emrat.

karrocë

tullumbace

2. Plotëso fjalinë dhe shkruaje në fletore.

Zogjtë ci..roj.. në pe.. .

87

ÇIMI PËRGATITET PËR NË SHKOLLË.

Çimi përgatitet për në shkollë.

Çimi	përgatitet	për në shkollë.

Çi	mi

Çi

Ç

Ç ç

ç - viç - vinç - llaç

ça - çantë - çarçaf - çamçakëz

çe - çekiç - çelës - çerdhe - reçel

çi - çizme - biçikletë - salçiçe

ço - çokollatë - çohem - çohesh - çohet
çohemi - çoheni - çohen

Çimi është gjashtë vjeç

1. Çimi po e pret shtatorin me shumë gëzim, se do të shkojë në shkollë. Mami i ka blerë Çimit një çantë të bukur. Në çantë, Çimi vuri Abetaren, lapsin dhe stilolapsin. Ai futi në çantë edhe çekiçin e vogël, si dhe një copë çamçakëz.

2. Kur e pa Çimin se ç'po bënte, mami i foli:

- Në çantë, Çimi, vihen vetëm librat dhe sendet që do të të duhen në shkollë.

Kukulla e Zanës

1. Zana e vogël ka një kukull që ia ka vënë emrin Odeta. Zana luan me kukullën çdo ditë, kur vjen nga kopshti në shtëpi. E lan kukullën dhe i vesh këmishën, breçkat, fustanin,çorapet e papuçet. Pastaj bën sikur po i jep të hajë. Pas pak e zhvesh, e puth, e vë në shtrat dhe i thotë:

2. - Odeta, fli tani. Mbylli ato syçkat e bukura. Natën e mirë!

3. Më vonë, i shkon pranë që ta zgjojë.

- Odeta, çohu tani, se të bëhet vonë për në çerdhe. Mos u bëj gjumashe!

USHTRIME

1. Vizatoji edhe ti dhe shkruaj nën to emrat.

çizme
çantë
biçikletë

2. Vizato dhe shkruaj nën to emrat.

furçë dhëmbësh çelës çadër

3. Plotëso fjalinë dhe shkruaje.

Dhëm... i laj.. me ..... .

GOTA E THYER

Gota e thyer

Gota | e thyer

e | thy | er

thy

th

th Th

tha - thashë - the - tha
thamë - thatë - thanë
the - thes - ethe - i thellë
thu - uthull - thupër - thumb

Gota e thyer

1. Mami, kur u kthye nga puna, e pyeti Gentin:
   - Kush e theu gotën?
   Genti, për të mbrojtur të motrën, Shpresën, i tha:
   - Gotën e theu macja.
2. Shpresa e qortoi Gentin dhe i tha mamit:
   - Mami, Genti nuk të tha të vërtetën. Gotën e theva unë.
3. Mami e lavdëroi Shpresën, që nuk pranoi ta fshihte fajin.

Bisedë në telefon

1. - Alo! Alo! Jam teta Moza.
U gëzova shumë, Elira, kur
më thanë se ke hyrë në punë.
Po ku?
2. - Në punishten artistike, teta
Moza, në repartin e thurjes.
Thurim shporta me thupra thane,
bëjmë korniza dhe çanta me
kashtë thekri dhe me xunkth.
Bëjmë gjithfarë sendesh të bukura.
3. - A je e kënaqur, Elira, me punën?
- Shumë, teta Moza.
- Të uroj sukses, Elira!
- Falemnderit, teta Moza.

USHTRIME

1. Vizatoji edhe ti dhe shkruaj nën to emrat.



gjethe
vreth
thikë

DRITANI I LEXON GJYSHES.

Dritani i lexon gjyshes.

Dritani	i	lexon	gjyshes.

le xon

xon

x

x X

xi - xixë - xixëllon - xixëllonjë

xo - lexo - lexoj - lexon - lexojnë

nx - nxito - nxitoj - nxiton - nxitojnë

nxënës - nxënëse - nxënësi - nxënësja

Dritani i lexon gjyshes

1. Gjyshja e Dritanit ka lexuar shumë libra. Po ka dy muaj që nuk po lexon, se i lodhen sytë. Tani edhe me syze lexon me vështirësi.
2. Kur Dritani ishte i vogël, gjyshja i lexonte atij libra të bukur për fëmijë. Tani, që gjyshja është e moshuar, i lexon Dritani asaj.
3. Gjyshja gëzohet shumë, kur dëgjon nipin e saj, Dritanin, që lexon bukur dhe pa gabime. Por nuk kënaqet kur ai nxitohet, se nuk dëgjon mirë.

Bashkë me një zog

Mbi degën e mollës
më erdhi një zog,
ciu - ciu - ciu,
më tha: - Të kam shok.
Abetaren zogu
në dorë ma pa:
- Mësomë dhe mua
të lexoj! - më tha.
Edhe ia filluam
që të dy me zë!
Ai: - Ciu - ciu!
Unë: - A, b, c !



Festa e Abetares

Abetare, fort të dua !
Me ato shkronjat e tua
dora ime u mësua,
mendja ime u ndriçua.
Kam mësuar të lexoj,
shkruaj bukur, recitoj,
edhe prindërve u fal
plot gëzime, sa një mal.

PËR T'U PRERË NGA NXËNËSI

86	Sporti zhvillon trupin
84	Oxhakët e fshatrave nxirrnin tym
82	Dritani i lexon gjyshes
80	Gota e thyer
78	Çimi përgatitet për në shkollë
76	Cicërimat e zogjve
74	Gjyshi në gjirin e familjes
72	Televizori
70	Agroni shënoi një gol të bukur
68	Manjola dhe Sonja
66	Yllka me Yllin janë shokë
64	Dhurata udhëton me tren
62	Burbuqja me Shqipen